



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.53, datë 30.06.2026

**“MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR 6%
PËR MUAJIN MAJ 2026”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 30.06.2026, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenin 30/1 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” si dhe Udhezimit nr. 3, datë 17.02.2017 i ndryshuar, VKM nr. 565, datë 09.08.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike. Udhezimi nr. 10, datë 26.09.2006, si dhe VKM nr.8, datë 14.05.2015 “Për kompesimin e faturës së energjisë elektrike për heqjen e fashës deri në 300 KËH si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 6 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

VENDOSI:

1. Mbi miratimin e Ndhmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin **Maj 2026** përfitojnë **26 familje** me një fond prej **90,391 lekë** nga këto **16 familje** përfitojnë kompesimin e energjisë elektrike me fond **18,664 lekë**.
2. Fondi gjithsej i shpenzuar për muajin **Maj 2026** është **109,055 lekë**.
3. Familjet përfituese sipas listës bashkëlidhur.
4. Nivelet e pagesës të jenë bazuar në V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, si dhe Udhezimit nr. 3, datë 17.02.2017, i ndryshuar.

Vendimi u miratua me 11 Vota pro, vota kundër - s'ka , abstenim – s'ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Elsa PETRITAJ

